



Projekt rajonal për monitorimin e proceseve gjyqësore  
Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor



Sundimi i së drejtës, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të rëndë të organizuar si dhe mbështetja për të krijuar institucione gjyqësore më efektive janë përbërës bazë të punës së OSBE-së.

#### Kuadri i përgjithshëm

OSBE-ja mbështet institucionet vendore në përpjekjet për të arritur qëndrueshmëri e mirëqenie afatgjatë dhe për të vënë në jetë përpjesitë e tyre strategjike vendore e rajonale.

OSBE-ja ka krijuar një bashkëpunim me Komisionin

European për t'i çuar më tej përpjesitë tona të përbashkëta programatike me anën e këtij Projekti Rajonal trevjeçar (2021- 2026) për Monitorim Gjyqësor.

Projekti zbatohet nëpërmjet Operacioneve në terren të OSBE-së në Tiranë, Sarajevë, Prishtinë, Podgoricë, Shkup dhe Beograd me mbështetjen dhe drejtimin e Zyrës për

Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) nën koordinimin e Qendrës për Parandalimin e Konfliktëve në Sekretariatit e OSBE-së.

Themelet e kësaj nisme rajonale u hodhën gjatë Samitit të vitit 2018 mes Bashkimit European dhe Ballkanit Perëndimor në Sofje, ku drejtuesit e qeverive të Europës Juglindore ranë dakord për të nisur monitorimin gjyqësor në çështjet e rënda të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

#### Objektivat e projektit

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është të mbështesë

një përgjigje gjyqësore më efektive ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor. Projekti ka për qëllim nxitjen e pavarësisë, cilësisë dhe efektshmërisë së sistemeve gjyqësore, duke i mbështetur këto në përpjekjet e tyre për të trajtuar korrupsionin e rëndë dhe krimin e organizuar, çështje që përbëjnë një kërcënim për qëndrueshmërinë dhe mirëqenien afatgjatë në të gjithë rajonin.

Mbështetje për një përgjigje më të efektshme gjyqësore ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor.



Funded by  
the European Union



Organization for Security and  
Co-operation in Europe

## Plani për arritjen e objektivave

Ky projekt do të shqyrtojë mënyrën e punës në terren, do të identifikojë probleme në sistem, do të sigurojë këshilla e propozime dhe do t'ua bëjë të ditura gjetjet përkatëse gjithë aktorëve të përfshirë, duke u dhënë zgjidhje mangësive të hasura në administrimin e drejtësisë.

## Zbatimi i projektit

Me anë të këtij projekti, të dhënat e mbledhura gjatë procesit të monitorimit do të analizohen për të pikasur probleme sistemike dhe shkaqet e mundshme në rrënjë të tyre, duke i krijuar, në këtë mënyrë, mundësinë OSBE-së dhe sistemit gjyqësor në gjashtë vendet përfituese nga Instrumenti II i Asistencës për Para Anëtarësimin (IPA), të përcaktojnë ku ka arritje të suksesshme dhe ku nevojiten përpjekje të mëtejshme në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kjo analizë do të jetë baza për hartimin e një plani të posaçëm për një politikë kontrolli të mëpasshëm me objektiva të përcaktuara, për reformën legjislative dhe veprimtaritë kushtuar rritjes së aftësisë.

OSBE-ja siguron që monitoruesit e saj do të respektojnë parimet e mos ndërhyrjes, objektivitetit dhe ruajtjes së



fshehtësisë në përputhje të plotë jo vetëm me Kodin e Sjelljes së OSBE-së dhe me metodologjinë e monitorimit gjyqësor, por edhe me legjislacionin kombëtar.

OSBE-ja bashkëpunon ngushtë me profesionistët e fushës së drejtësisë për të përforcuar marrëdhëniet dhe besimin e ndërsjellë dhe për t'i përfshirë ata në kontributin që i jepet përmirësimit të punës së institucioneve të tyre.

## Përzgjedhja e çështjeve gjyqësore për monitorim

Çështjet gjyqësore që i nënshtrohen monitorimit përzgjidhen në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga ODIHR-i, sipas marrëveshjes mes OSBE-së dhe Komisionit Europian.

## Rezultatet e projektit



Nga rezultatet e projektit do të ketë dobi secili prej gjashtë vendeve përfituese nga Instrumenti II i Asistencës për Para-Anëtarësim (IPA) sepse qëllimi i projektit është përforcimi i shtetit të së drejtës e, si rrjedhojë, përmirësimi i qëndrueshmërisë sociale dhe mirëqenies në Ballkanin Perëndimor.

Për më tepër hollësi mbi projektin, hyni në [www.osce.org/WesternBalkansTrialMonitoring](http://www.osce.org/WesternBalkansTrialMonitoring) ose ndiqni veprimtarinë tonë në mediat sociale nëpërmjet [#RegTrialMonitoring](https://twitter.com/RegTrialMonitoring)

## Ndiqni OSBE-në



Ky publikim është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Për përmbajtjen, që nuk pasqyron vetvetiu këndvështrimin e Bashkimit Europian, mban përgjegjësi vetëm OSBE-ja.

OSCE Secretariat  
Wallnerstrasse 6  
1010 Vienna, Austria

E-mail: [Eirini.Patsea@osce.org](mailto:Eirini.Patsea@osce.org)  
[www.osce.org/WesternBalkansTrialMonitoring](http://www.osce.org/WesternBalkansTrialMonitoring)



Funded by  
the European Union



Organization for Security and  
Co-operation in Europe